

**Lënda:** Kthim përgjigje

**Subjektit:** EL.ED.ER shpk

**Për dijeni:** KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në përgjigje të shkresës suaj të datës 13.10.2021, në të cilën kërkonte çrregjistrimin e pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të z. Marlind Myftiu, për periudhën 1 mars 2016 deri 17 janar 2017, periudhë për të cilën figuron gabimisht dhe pa dijeninë e tij i regjistruar në listpagesat e subjektit Edmond Kushi, person fizik me NIPT L423100029D, ju bëjmë me dije se:

Mbështetur në ligjin nr. 9136, datë 11.09.2003 *“Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, ju ka kaluar organeve tatimore.

Organet e sigurimeve shoqërore, si përpunues të të dhënave personale (*listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore etj.*), përpunojnë këto të dhëna vetëm në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 *“Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, si dhe transmetohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet webService, të dhëna të cilat i disponojmë nga viti 2012 e në vazhdim.